

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8133
E enjte, 4 shtator 2025
Çmimi 0.50 €

KMDLNj: Amerikanët
nuk e monitorojnë
Gjykatën Speciale I FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

A MUND TË FUNKSIONOJË KUVENDI PA NJË NËNKRYETAR?

 I FAQE 4-5

Njohësit e Kushtetutës kanë thënë se Kuvendi konsiderohet i konstituuar vetëm pasi të zgjidhen kryetari dhe pesë nënkryetarët, por ka edhe të atillë që thonë se Kuvendi mund të konsiderohet i konstituuar edhe pa një nënkryetar. Ish-gjyqtari i

Gjykatës Kushtetuese, Kadri Kryeziu, ka treguar se çfarë nuk thotë Kushtetuta në nenin 67. Sipas tij, Kushtetuta nuk thotë që patjetër duhet të zgjidhen menjëherë, që në mbledhjen e parë, të gjithë anëtarët e Kryesisë. "Kushtetuta nuk thotë që

Kryesia është jofunksionale, nëse për çfarëdo arsye, nuk zgjidhet një nënkryetar. Kushtetuta nuk thotë që Kuvendi nuk mund të funksionalizohet sepse nuk zgjidhet një nënkryetar", ka deklaruar Kryeziu

**KQZ-ja
DECERTIFIKON
NËNTË KANDIDATË
PËR ASAMBLE
PËR ZGJEDHJET
E 12 TETORIT** F. 6



**KURTI NUK
SHKOI NË
PROKURORI
SI DËSHMITAR
PËR REZERVAT
SHTETËRORE,
SHKOI NË
GJYKATË SI
VIKTIMË E
KANOSJES** F. 7



AKTUALE



**BASHA NË PREKAZ: ËSHTË OBLIGIM
YNI TA VAZHDOJMË RRUGËN QË ATA
TRASUAN** F. 5

**FSK-ja PO REALIZON USHTRIMIN
FUSHOR "UJKU SHIGJETË"** F. 6

**MESAZH KËRCËNUES NDAJ KURTIT
NË MITROVICËN E VERIUT, POLICIA
NIS HETIMET** F. 7

EKONOMI



**RRITJA HISTORIKE E ÇMIMIT TË
ARIT, SI PO E DËMTOËN DOLLARIN
AMERIKAN?** F. 8

**ZBULOHEK LABORATOR DROGE NË
PRISHTINË, VJEDHJE E ENERGJISË
ELEKTRIKE MBI 32 MIJË EURO** F. 8

SPORT



**VOJVODA DHE JASHARI: SYNOJMË
FITORE NDAJ ZVICRËS** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraelitët protestojnë teksa ushtria shton sulmet në Gazë

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Qytetarët izraelitë kanë dalë në rrugët e Jerusalemit të mërkurën për ta kundërshtuar thirrjen në ushtri të dhjetëra mijëra rezervistëve për një ofensivë që është dënuar ndërkombëtarisht dhe që ka nxitur frikën në Izrael se mund t'i rrezikojë pengjet që ende po mbahen në Rripin e Gazës. Protestuesit e akuzojnë kryeministrin e vendit, Benjamin Netanyahu, dhe kabinetin e tij, se nuk kanë arritur ta bëjnë një marrëveshje armëpushimi dhe në vend të kësaj kanë përshpejtuar pushtimin që, sipas spitalëve në Gazë, është duke e rritur dukshëm numrin e viktimave. "Duhet të ndërmarim veprim ekstrem që të na kujtojnë dikush. Nuk ka shtet që i braktis qytetarët e vet", tha Yael Kuperman, një protestuese pranë Knessetit, për transmetuesin publik izraelit "Kan". Izraelitët kanë protestuar shpesh gjatë luftës, duke kërkuar një marrëveshje që sjell pengjet

izraelite në shtëpitë e tyre.

Izraeli kryen sulme në pjesë të Gazës

Ndërkohë, zyrtarë spitalorë i thanë agjencisë së lajmeve "Associated Press" se të paktën 24 njerëz u vranë nga sulmet gjatë natës së mbrëmshme dhe mëngjesin e së mërkurës. Spitali Nasser tha se i pranoi 10 trupa, përfshirë një person që kërkonte ndihmë në Rafah dhe një fëmijë të vranë nga një sulm në jug të Gazës. Spitali Shifa tha se mori trupat e 14 personave, mes tyre dy fëmijë dhe katër gra, ndërsa Spitali Al-Quds raportoi një viktimitë tjetër nga sulmet izraelite. Izraeli thotë se Qyteti i Gazës - qyteti më i madh palestinez, si në Rripin e rrethuar ashtu edhe në Bregun e pushtuar Perëndimor - mbetet bastion i Hamasit dhe se nën të ndodhet një rrjet i gjerë tunelesh, edhe pas bastisjeve të mëhershme gjatë luftës.



Hamasi është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Izraeli ka shtuar sulmet ajrore dhe tokësore në periferi të Qytetit të Gazës, veçanërisht në lagjet perëndimore ku, sipas grupeve humanitare që koordinojnë ndihmën për të zhvendosurit, njerëzit po detyrohen të ikin drejt bregdetit. Palestinezët dhe punonjësit e ndihmës thonë se kërcënimi i

dyfishtë i luftimeve dhe urisë po bëhet gjithnjë e më i madh për familjet në qytetin e Gazës, shumica e të cilave janë zhvendosur disa herë gjatë luftës 23-mujore. Zyrtarët e spitaleve dhe Ministria e Shëndetësisë e Gazës thanë të mërkurën se numri i viktimave po rritet, pasi njerëzit po vriten nga sulmet ajrore, duke tentuar të marrin ndihma, ose si pasojë e urisë ekstreme. Ministria tha se

113 palestinezë u vranë të martën - më shumë se gjysma në qytetin e Gazës - gjatë 24 orëve të fundit. Ky numër, i përsëritur shpesh javët e fundit, u publikua një ditë pasi Netanyahu dhe komandantët izraelitë u thanë rezervistëve se ofensiva po hynte në atë që ata e shpresonin si "faza vendimtare" e luftës. Ministria raportoi të mërkurën se pesë të rritur dhe një fëmijë humbën jetën nga kequshqyerja në 24 orët e fundit, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 367, përfshirë 131 fëmijë gjatë gjithë luftës. Lufta në Gazë nisi më 7 tetor 2023, kur Hamasi vrau 1 200 njerëz në jug të Izraelit dhe mori rreth 250 pengje, sipas shifrave izraelite. Prej atëherë më shumë se 63 633 palestinezë janë vranë gjatë luftës së Izraelit, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila është pjesë e qeverisjes së Hamasit dhe e përbërë nga profesionistë mjekësorë.

Kostot e Evropës pa Amerikën, çfarë ndodh nëse ShBA tërheq ushtrinë pas rishikimit të planit të mbrojtjes?



LONDËR, 3 SHTATOR - Njoftimet për planet e një rishikimi të mbrojtjes nga ana e Shteteve të Bashkuara kanë ngjallur shqetësimin se shtetet evropiane mund të përballen me një kosto të lartë për riarmatimin, të cilën ekspertët e llogarisin në gati trilion dollar. Teksa përmend gjasat e një tërheqjeje dramatike të forcave amerikane nga kontinenti, raporti prej 106-faqesh i Institutit Ndërkombëtar për Studime Strategjike (IISS), me seli në Londër, evidenton mangësi në të gjitha fushat: në prodhim, inteligjencë dhe pajisje ushtarake si raketat me rreze të gjatë veprimi apo në sistemet e mbrojtjes ajrore

dhe raketore. "Një nga arsyt kryesore për këtë urgjencë më të madhe është kërcënimi ushtarak nga Rusia dhe pasiguria mbi angazhimin e ShBA-së për mbrojtjen e aleatëve evropianë", thuhet aty. "Vlerësimet strategjike ndryshojnë midis vendeve evropiane për atë se sa shpejt forcat ruse mund të përbëjnë një kërcënim të drejtpërdrejtë për NATO-n në Evropë, e afatet e tyre zakonisht variojnë nga dy deri në pesë vjet", theksohet më tej. Sakaq, rishikimi global i forcave të Pentagonit pritet të publikohet gjatë këtij muaji dhe të paraqesë një zhvendosje të burimeve

ushtarake nga Evropa për në Azi/Paqësor. "Disa zyrtarë të NATO-s besojnë se mund të ndodhë një reduktim deri në 30 për qind i trupave amerikane", vazhdon raporti që mban titullin "Përparimi dhe mangësitë në mbrojtjen e Evropës: një vlerësim". Udhëheqësit evropianë gjatë këtij viti kanë bërë plane në mënyrë se si t'u përgjigjen këtyre sfidave. Në mars, në një samit të Bashkimit Evropian udhëheqësit u zotuan se do të shpenzojnë miliarda në mbrojtje, teksa presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e quajti një "moment përcaktues për Evropën".

"FBI-ja" greke godet kontrabandën e karburantit, 22 të arrestuar dhe disa pika të pezulluara

ATHINË, 3 SHTATOR - Një operacion i gjerë policor është zhvilluar në Greqi nga Drejtoria për Luftën Kundër Krimit të Organizuar, duke goditur një rrjet të mirë organizuar që merrej me kontrabandën e karburanteve dhe mashtrimin ndaj qytetarëve. Që prej të martës, oficerët kanë ndërhyrë në dhjetëra pika karburanti dhe depo të benzinës në zona të ndryshme të vendit, përfshirë Atikën, Selanikun, Artën, Tri kalan, Larisën, Katerinin, Volosin dhe Lakoninë. Këto

subjekte ishin nën vëzhgim të vazhdueshëm nga autoritetet dhe sapo u konstatua aktiviteti i paligjshëm, nisi operacioni masiv. Deri tani janë arrestuar 22 persona, ndërsa disa pika karburanti janë pezulluar nga aktiviteti. Arrestimet janë kryer në gjashtë qytete. Sipas autoriteteve, të dyshuarit kishin instaluar softuer të paligjshëm në pompë, duke manipuluar sistemin elektronik të matjes dhe duke u shitur klientëve sasi më të vogla karburanti nga ajo që



tregohej në aparaturë. Gjithashtu, ndaj tyre rëndojnë

edhe akuzat për evazion fiskal dhe pastrim parash, përmes

përdorimit të dokumenteve fiktive. Gjatë kontrolleve, në Sindos të Selanikut u zbulua një depo me tretës që ishin importuar ilegalisht nga Rumania. Dyshohet se pas përpunimit të karburantit në këtë depo, ai shpërndahej në disa nga stacionet e përfshira në skemë. Hetimet kanë zbuluar edhe lidhje të të dyshuarve me individë në Bullgari, vend nga ku besohet se ishte organizuar edhe importi i tretësve të përdorur në përzierjen e karburanteve.

Çmimet e teksteve shkollore, MINT-i kontrole në gjithë Kosovën

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, ka njoftuar se nga data 1 shtator ka rritur intensitetin e inspektimeve në të gjithë territorin e Kosovës. Qëllimi i këtyre kontrolleve është të sigurohet mbrojtja e të drejtave të autorit dhe

monitorimi i çmimeve të teksteve shkollore. Në njoftimin e MINT-it thuhet se deri tani janë inspektuar mbi 30 operatorë ekonomikë që ushtrojnë këtë veprimtari dhe në rastet ku janë evidentuar shkelje ligjore janë marrë masa ndëshkuese në përputhje me legjislacionin. “Ky hap është ndërmarrë për të siguruar respektimin e

kërkesave ligjore dhe për të mënjeluar shkeljet që mund të dëmtojnë konsumatorët si dhe krijimtarinë intelektuale”, thuhet në komunikatë. Inspektorati paralajmëroi se do t’i vijojë kontrollet e rrepta edhe në ditët në vijim, duke monitoruar shtëpitë botuese dhe shpërndarësit, për të garantuar se qarkullimi i teksteve shkollore bëhet në

përputhje me Ligjin mbi të Drejtat e Autorit. Po ashtu, do të vazhdojë mbikëqyrja e çmimeve me synim që ato të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me rregullat e konkurrencës. Inspektorati u ka bërë thirrje të gjitha palëve të përfshira, përfshirë shtëpitë botuese dhe autorët - që të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente



për një treg të drejtë dhe transparent, duke respektuar të drejtat e autorëve dhe duke garantuar çmime të përballeshme për tekstet shkollore.

KMDLNJ: AMERIKANËT NUK E MONITEROJNË GJYKATËN SPECIALE

Nga 15 shtatori 2025 para Gjykatës Speciale fillon dëshmia e dëshmitarëve që janë ftuar nga mbrojtja e Hashim Thaçit dhe Jakup Krasniqit. Mbrojtja e Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit nuk i ka paraqitur GJS asnjë dëshmitar. Dëshmitarët e mbrojtjes janë kryesisht ndërkombëtarë, bartës të posteve të larta politike dhe ushtarake në kohën e luftës në Kosovë dhe në periudhën e pasluftës. Në opinion doli një informatë se amerikanët do ta monitorojnë GJS e që u mirëprit për faktin se kjo gjykatë ishte krejtësisht jotransparente dhe hermetikisht e mbyllur sidomos për monitoruesit për të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria. Realisht, vetëm Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq nga Gjeneva dhe Avokati i Popullit i Holandës kanë pasur të drejtë ta monitorojnë punën e

GJS dhe ZPS, mirëpo këta janë sjell si “amici curie” apo miq të gjykatës dhe me asgjë nuk janë identifikuar si mbrojtës të të drejtave të njeriut të personave të arrestuar, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. Nga praktika e gjykatave të tilla kurrë nuk ka pasur gjykata më jotransparente dhe të instrumentalizuara nga politika. Si qëndron puna me “monitoruesit” amerikanë? E vërteta është se këta nuk janë monitorues, por zyrtarë të shtetit amerikan që do të jenë të pranishëm gjatë dhënies së dëshmisë të dëshmitarëve që janë shtetas amerikanë. Profili profesional i tyre është ose prokurorë, gjykatës apo specialistë juridikë me qëllim të mbrojtjes së sekreteve të shtetit amerikan nëse ato sfidohen para gjykatës gjatë dëshmisë.



Në rast të marrjes në pyetje të dëshmitarit nga prokurori, gjykatësi, mbrojtësi i viktimave apo avokati, që paraqet rrezik për zbulim të sekretit shtetëror, zyrtari i pranishëm apo “monitoruesi” kërkon nga dëshmitari ta ndërpresë dëshminë. Opinioni është

keqinformuar për rolin dhe mandatin e zyrtarit të shtetit amerikan apo “monitoruesit” dhe KMDLNj sqaron opinionin se kjo nuk ka fare të bëjë me të akuzuarin aq më pak me monitorim të punës së gjykatës. KMDLNj ripohon se kjo gjykatë në mënyrë brutale i ka shkelur

të drejtat e njeriut duke diskriminuar pariparueshëm të akuzuarit dhe të dënuarit sikur duke e kompromituar parimin e prezumimit të pafajësisë si një ndër shtyllat kryesore për një proces të drejtë, të pavarur gjyqësor dhe të pandikuar nga politika dhe grupet e interesit.

KOSOVA KËRKON PYETËSORIN DHE STATUSIN E VENDIT KANDIDAT NË BE, KOS: SHQIPËRIA E MALI I ZI MË TË AVANCUARA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, gjatë një takimi joformal të ministrave për çështje evropiane të organizuar në Kopenhagë, ka theksuar se Kosova ka shënuar përparim në zbatimin e reformave dhe avancim të konsiderueshëm vitet e fundit. Sipas tij, Kosova ka arritur, mes të tjerash, rritjen më të shpejtë ekonomike në rajon, ulje të



papunësisë nga 23.8 % në 10.9 % në vetëm katër vjet, përmirësim

në indekse ndërkombëtare e dyfishim të investimeve të huaja

drejtëpërdrejt. Ai gjatë takimit me temë “Kriteret e Kopenhagës dhe integrimi gradual”, theksoi se aplikimi për anëtarësim në dhjetor 2022 është tregues i synimit dhe gatishmërisë për avancim të mëtejshëm, gjersa Kosova po zbaton Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit për gati një dekadë tashmë. Bislimi nënvizoi se institucionet tona kanë dëshmuar nivelin e lartë të përgatitjes, andaj dhe është e nevojshme vlerësimi i tyre në bazë të meritokracisë, duke pranuar pyetësorin dhe duke marrë statusin e vendit kandidat.

Krahas ministrave, pjesëmarrëse në këtë diskutim ishte edhe komisionarja për Zgjerim, Marta Kos, e cila, pas takimit, në një konferencë për medie, tha se Shqipëria e Mali i Zi janë dy vendet candidate që përparuan më herët drejt anëtarësimit në BE. Ndërkohë, Kos ka shkruar në “X”, se bashkë me ministrat e Evropës kanë diskutuar për ankorimin e respektit për sundimin e ligjit, sjelljen e përfitimeve të hershme për vendet candidate, përgatitjen e unionit për anëtarët e rinj dhe komunikimin e përfitimeve të zgjerimit për qytetarët e BE-së.

Komuna ndihmon 45 fermerë me pajisje bujqësore

Prishtinë, 3 shtator - Komuna e Podujevës ka bërë shpërndarjen e pajisjeve bujqësore për 45 fermerë përfitues. Prej tyre 25 fermerë kanë përfituar motokultivatorë

me frezë dhe 20 të tjerë shpërndarëse plehu. Në ceremoninë e shpërndarjes morën pjesë kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi dhe drejtoresha e Bujqësisë, Lirie

Hoti. Me këtë rast, kryetari Bulliqi i uroi fermerët përfitues dhe tha se këto mjete do t’ua lehtësojnë punën fermerëve dhe do të ndikojnë në rritjen e produktivitetit. “Gjatë gjithë

këtij mandati i kemi ndihmuar me subvencione fermerët tanë, të cilët janë shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik të komunës”, ka theksuar Bulliqi.





A MUND TË FUNKSIONOJË KUVENDI PA NJË NËNKRYETAR?

Njohësit e Kushtetutës kanë thënë se Kuvendi konsiderohet i konstituuar vetëm pasi të zgjidhen kryetari dhe pesë nënkryetarët, por ka edhe të atillë që thonë se Kuvendi mund të konsiderohet i konstituuar edhe pa një nënkryetar. Ish-gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kadri Kryeziu, ka treguar se çfarë nuk thotë Kushtetuta në nenin 67. Sipas tij, Kushtetuta nuk thotë që patjetër duhet të zgjidhen menjëherë, që në mbledhjen e parë, të gjithë anëtarët e Kryesisë. “Kushtetuta nuk thotë që Kryesia është jofunksionale, nëse për çfarëdo arsye, nuk zgjidhet një nënkryetar. Kushtetuta nuk thotë që Kuvendi nuk mund të funksionalizohet sepse nuk zgjidhet një nënkryetar”, ka deklaruar Kryeziu

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se sa i përket procesit të konstituimit të institucioneve të dala nga zgjedhjet e 9 gushtit, ajo do të veprojë “në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi” me qëllim që të garantohet stabiliteti institucional. Këto deklarata ajo i ka bërë gjatë takimeve të ndara që ka zhvilluar me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, dhe atë të Mbretërisë së Bashkuar, Jonathan Hargreaves. “Në kuadër të diskutimeve u diskutua edhe procesi i konstituimit të institucioneve si rezultat i zgjedhjeve të 9 shkurtit. Me këtë rast, presidentja Osmani riafirmoi se veprimet e saj do të jenë gjithmonë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet, duke siguruar stabilitet institucional

dhe respektimin e vullnetit qytetar”, u tha në njoftimin pas takimit me ambasadorin britanik. Njoftim i ngjashëm u lëshua edhe për takimin me ambasadorin gjerman. Presidenca e Kosovës tha se po analizon procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës, pasi kryetari i ri i organit ligjvënës, Dimal Basha, e shpalli të përmbyllur seancën konstituive më 30 gusht, edhe pse nuk u zgjodh nënkryetari nga radhët e komunitetit serb. Më 1 shtator Osmani priti në takim Bashën me të cilin diskutoi për çështjen e Kuvendit. “Në këtë takim kryetari Basha e ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në anën tjetër, presidentja Osmani e ka informuar kryetarin Basha se ekipi ligjor i Presidencës është duke bërë analizën lidhur me procesin e konstituimit të

Kuvendit të Kosovës”, tha Presidenca pas takimit. Gjatë seancës konstituive të 30 gushtit, Basha hodhi në votim, përmes shortit, kandidatët e mbetur për nënkryetarë të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb. Pasi asnjëri prej tyre, gjatë tri herëve që u hodhën në votim, nuk mori 61 votat e nevojshme, Basha tha se Kuvendi duhet ta vazhdojë punën dhe e shpalli ta “përmbyllur” procesin e konstituimit. Gjatë seancës konstituive të 30 gushtit, Basha hodhi në votim, përmes shortit, kandidatët e mbetur për nënkryetarë të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb. Pasi asnjëri prej tyre, gjatë tri herëve që u hodhën në votim, nuk mori 61 votat e nevojshme, Basha tha se Kuvendi duhet ta vazhdojë punën dhe e shpalli të “përmbyllur” procesin e konstituimit. Ky vlerësim i Bashës është

kundërshtuar nga partitë e tjera parlamentare.

Pse nuk u zgjodh kryetari i pestë i Kuvendit nga komuniteti serb?

Lista Serbe, e cila në Kuvend ka 9 nga 10 vendet e rezervuara për serbët, këmbënguli ta propozonte Sllavko Simiqin. Megjithatë, ai nuk arriti të siguronte 61 votat e nevojshme as pas tri raundeve të votimit. Pasi Lista Serbe nuk pranoi të propozonte dikë tjetër për nënkryetar, kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, vendosi të hidhte short, sipas Rregullores së punës së Kuvendit, për të nxjerrë një

emër tjetër nga komuniteti serb. Përveç disa deputetëve të tjerë të Listës Serbe, për këtë pozitë u propozua edhe Nenad Rashi nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, aktualisht ministër në detyrë në qeverinë e Albin Kurtit. As Rashiqi nuk i mori votat e nevojshme për t’u zgjedhur nënkryetar. Rregullorja parasheh që “kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb”. Ndërkaq, Kushtetuta e Kosovës thotë se nënkryetari “do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara të komunitetit serb”. Njohësit e Kushtetutës kanë thënë për “Radion Evropa e Lirë” se Kuvendi konsiderohet i konstituuar vetëm pasi të zgjidhen kryetari dhe pesë nënkryetarët. Pas konstituimit të Kuvendit, sipas ligjeve në fuqi, presidentja duhet t’i kërkojë partisë fituese, në këtë rast Lëvizjes Vetëvendosje, emrin e mandatarit për qeverinë e re. Mandatarin më pas ka 15 ditë kohë që t’i sigurojë 61 votat e nevojshme për ekzekutivin e ri. Nëse ai dështon, atëherë është në diskrecionin e presidentes se kë ta mandatojë për formimin e qeverisë së re. Ish-gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kadri Kryeziu, ka reaguar ndaj ish-kryetarit të

ZKA-ja DËRGON 69 RASTE NË PROKURORI, EVIDENTON PROBLEME NË MENAXHIMIN E FONDEVE PUBLIKE

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka dërguar te Prokurori i Shtetit gjithsej 69 çështje të evidentuara në 103 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për sezonin 2024/2025.

Zëvendësauditatori i përgjithshëm i ZKA-së, Beza Halilaj, ka thënë se këto çështje lidhen kryesisht me dyshime për shkelje dhe parregullsi në prokurimin publik, subvencione dhe transfere, investime kapitale, si dhe paga dhe mëditje. “Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka dërguar te Prokurori i Shtetit gjithsej 69 çështje të evidentuara në 103 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për sezonin 2024/2025. Këto çështje lidhen kryesisht me dyshime për shkelje dhe parregullsi në prokurimin publik, subvencione dhe transfere, investime kapitale, si dhe paga dhe mëditje.

Konkretisht, shpërndarja e rasteve sipas fushave është: 37 raste në prokurimin publik, 19 raste në

subvencione dhe transfere, 8 raste në investime kapitale, 4 raste në paga dhe mëditje dhe 1 rast në të hyrat. Sipas llojit të institucioneve, 47 raste vijnë nga komunat, 12 raste nga ministritë, 7 raste nga ndërmarrjet publike dhe 3 raste nga institucione të tjera. ZKA tashmë ka marrë konfirmim nga Zyra e Prokurorit të Shtetit se të gjitha 69 çështjet janë dorëzuar te prokuroritë përkatëse për veprime të mëtejshme ligjore. Sipas planit vjetor, pas publikimit të raporteve të auditimit të pajtueshmërisë dhe të performancës, rastet e reja të identifikuar do të analizohen dhe do t’i përcillen Prokurorit të Shtetit gjatë muajve në vijim”, ka thënë Halilaj. Ai ka theksuar se ZKA-ja ka evidentuar probleme të theksuara në mbrojtjen e pasurive natyrore dhe në menaxhimin e energjisë së ripërtëritshme.

Ndërsa auditorja e përgjithshme e ZKA-së, Vlora Spanca, ka paraqitur rezultatet e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin



2024, duke bërë me dije se buxheti i shtetit është mbyllur me suficit, por me sfida serioze në zbatimin e projekteve kapitale. “T’ju prezantojmë nga afër rezultatet e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2024, të cilin, në përputhje me mandatin

kushtetues dhe ligjor, e kemi dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës para datës 31 gusht. Ky raport përfshin opinionin e auditimit mbi Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2024, si dhe një përmbledhje të

rezultateve kryesore të sezonit auditues 2024/2025. Me përfundimin e këtyre raporteve, Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar planin vjetor të punës për sezonin 2024/2025, duke përmbyllur gjithsej 127 auditime”, ka theksuar Spanca.

BASHA NË PREKAZ: ËSHTË OBLIGIM YNI TA VAZHDOJMË RRUGËN QË ATA TRASUAN



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, së bashku me nënkryetaren Albulena Haxhiu, bënë homazhe dhe vendosën lule në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Basha e ka cilësuar Prekazin vend ku liria jonë mori kuptimin më të thellë falë sakrificës sublime të familjes Jashari. “Heroizmi i komandantit Adem Jashari dhe 58 anëtarëve të familjes së tij është themeli mbi të cilin u ngrit çlirimi dhe pavarësia e Kosovës. Prekazi mbetet përjetësisht burim frymëzimi për vetëdijen tonë kombëtare, për unitetin dhe përkushtimin tonë ndaj atdheut”, ka thënë kryetari

Basha. Pas Prekazit, kryetari Basha vazhdoi nderimet te varri i presidentit Ibrahim Rugova dhe te varri i veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, simbolit të rezistencës, Adem Demaçi. Kryetari Dimal Basha dhe nënkryetarja Albulena Haxhiu bënë nderime edhe te Memoriali “Heroinat” dhe përkujtuan mbi 20 000 gra shqiptare të dhunuara gjatë luftës nga regjimi fashist i Millosheviqit. “Nderim i përjetshëm për të gjithë kontribuesit e lirisë sonë. Është obligim dhe detyrë e jona e përhershme ta vazhdojmë rrugën që ata trasuan me veprat e tyre”, ka thënë Basha.

Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, pas deklarës së këtij të fundit se Kuvendi i Kosovës nuk mund të konstituohet pa zgjedhur të gjithë nënkryetarët e komuniteteve shqiptare, serbe dhe joshqiptare.

Hasani kishte deklaruar se, sipas Kushtetutës, tri vendimeve të mëparshme dhe rregullores së Kuvendit, konstituimi i Kuvendit është i kushtëzuar nga zgjedhja e të gjithë nënkryetarëve, për shkak se secili ka vende të garantuara. Në një reagim të gjatë, Kadri Kryeziu ka shpjeguar se Kushtetuta e Kosovës, në nenin 67, përcakton që Kuvendi zgjedh kryetarin dhe pesë nënkryetarë, të

cilët formojnë Kryesinë që menaxhon funksionimin administrativ të Kuvendit në përputhje me rregulloren e aprovuar nga vetë Kuvendi. “Çfarë thotë Kushtetuta në nenin 67? Kushtetuta thotë që Kuvendi i zgjedh kryetarin dhe pesë nënkryetarë. Më pas thotë që këta gjashtë të zgjedhur e formojnë kryesinë që menaxhon funksionimin administrativ të Kuvendit në pajtim me një rregullore që e aprovon vetë Kuvendi. Kaq. Çfarë nuk thotë Kushtetuta në nenin 67? Kushtetuta nuk thotë që patjetër duhet të zgjidhen menjëherë, që në mbledhjen e parë, të gjithë

anëtarët e kryesisë. Kushtetuta nuk thotë që kryesia është jofunksionale nëse, për çfarëdo arsye, nuk zgjidhet një nënkryetar. Kushtetuta nuk thotë që Kuvendi nuk mund të funksionalizohet sepse nuk zgjidhet një nënkryetar”, ka deklaruar Kryeziu. Sipas Kryeziut, Kushtetuta nuk e detyron zgjedhjen e menjëhershme të të gjithë anëtarëve të kryesisë dhe as nuk e ndalon funksionimin e Kuvendit nëse ndonjë nënkryetar nuk zgjidhet menjëherë. “Kushtetuta e Kosovës vërtet i njeh 20 vende të garantuara në Kuvend për minoritetet, por kjo nuk do të thotë se nuk ka e nuk mund të ketë

Kuvend të Kosovës nëse, për çfarëdo arsye, minoritetet vendosin t’i bojkotojnë proceset politike në vend. Si dolën në zgjedhje minoritetet, si nuk dolën në zgjedhje, edhe sikur kurrë të mos i zënë ato 20 vende të garantuara, Kuvendi ekziston, funksionon, vepron, nxjerr ligje dhe e udhëheq jetën e këtij shteti. Minoritetet e kanë fjalën e fundit në gjithçka që ka të bëjë me të drejtat e tyre si komunitete, por nuk kanë as fjalë të fundit dhe as veto në funksionalizimin e Republikës. Edhe njëherë, Republika ec, vazhdon, jeton, zhvillohet, përparon, deshën apo nuk deshën minoritetet të marrin

pjesë në jetën politike e juridike të vendit. I kujt more është ky shtet? Ju vret Zoti dhe gjaku i dëshmorëve nëse harroni që në radhë të parë ky shtet është i shqiptarëve. Minoritetet janë të barabartë para ligjit e kushtetutës, por nuk janë pronarë dhe as titullarë të këtij shteti. Populli shqiptar është pronar, titullar, është shtylla konstituive e kësaj Republike, prandaj i kemi 100 deputetë të zgjedhur direkt nga populli në Kuvend. Nuk mund që një Simiq apo një kushdo, a një recidivist delikuent si Enver Hasani, të zhveshë një popull të tërë nga e drejta e pronësisë mbi këtë shtet”, ka thënë Kryeziu.

Nis viti i ri shkollor në Qendrën Korrektuese të Dubravës

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ka nisur viti i ri shkollor 2025/26 në Qendrën Korrektuese të Dubravës përmes paraleles së ndarë “Rudina” të Shkollës së Mesme Teknike “Mit’hat Frashëri” nga Gurrakoci. Në njoftim bëhet me dije se me të gjitha përgatitjet paraprake të përfunduara nga personeli mësimdhënës, materialet shkollore, mjetet didaktike e deri te pajisjet teknologjike, procesi mësimor ka filluar me

sukses. Në këtë vit shkollor në klasën X janë regjistruar një numër i konsiderueshëm nxënësish të cilët do t’i ndjekin mësimet në teori dhe praktikë nën kujdesin e stafit profesional. “Arsimi dhe edukimi mbeten një nga shtyllat kryesore të procesit të risocializimit, duke i dhënë secilit individ mundësinë për zhvillim personal dhe ndërtimin e një të ardhme më të mirë.

Përmes arsimit nxënësit fitojnë aftësi, njohuri të dobishme dhe, mbi të gjitha, besim në veten e tyre. Qendra Korrektuese e Dubravës, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Teknike ‘Mit’hat Frashëri’ - paralelja ‘Rudina’, mbetet e përkushtuar që përmes edukimit të kontribuojë në riedukimin, integrimin dhe zhvillimin e të dënuarve”, thuhet tutje në njoftim.



KQZ-JA DECERTIFIKON NËNTË KANDIDATË PËR ASAMBLE PËR ZGJEDHJET E 12 TETORIT



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e së mërkurës ka decertifikuar nëntë kandidatë për asamble në zgjedhjet komunale të parapara të mbahen më 12 tetor. Agim Millaku, Shaban Mehani, Tefik Beqiri, Vlora Gashi, Bajram Pireva, Afrim Koshi, Drita Qela, Gunej Birqi dhe Arjeta Birqi janë kandidatët që janë decertifikuar nga gara. Emrat e tyre u hoqën me kërkesë të kandidatëve për t’u tërhequr nga procesi zgjedhor. Ndërkohë, e premtyja është afati i fundit që KQZ-ja ta certifikojë listën e votuesve. Fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale do të nisë më 13 shtator, ndonëse tashmë një numër i kandidatëve për kryetarë të komunave e kanë filluar atë, duke paraqitur zgjidhjet përmes të

cilave synojnë t’i adresojnë problemet kryesore të komunave. KQZ-ja në muajin korrik kishte marrë vendim për miratimin e kërkesës për ridestininim të buxhetit për zgjedhjet lokale. Kjo kërkesë është bërë pasi që KQZ-ja kishte kërkuar nga qeveria në detyrë ndarjen e 6.5 milionë eurove të tjera, vendim për të cilin ende nuk është dhënë miratimi. Ndërkohë, partitë politike veçse kanë finalizuar listën e kandidatëve për kryetarë të komunave dhe kanë nisur fushatën zgjedhore. Zgjedhjet lokale do të mbahen më 12 tetor. Për herë të fundit ishin mbajtur në vitin 2021. Procesi zgjedhor që zhvilluar në të gjitha 38 komunat e vendit, në dy raunde: raundi i parë më 17 tetor dhe raundi i dytë më 14 nëntor 2021.

SALLAHU TAKON DREJTORËT E SHKK-SË, DISKUTUAN PËR MASAT E REJA QË GARANTOJNË RITJEN E TRANSPARENCËS

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka pritur drejtorët e Shërbimit Korrektues të të gjitha qendrave korrektuese të vendit për një takim pune të fokusuar në menaxhimin dhe sigurinë e institucioneve korrektuese. Gjatë takimit u diskutua mbi sfidat aktuale dhe për masat e reja që garantojnë rritjen e transparencës, integritetit dhe efikasitetit në funksionimin e burgjeve. Sallahu theksoi se Ministria e Drejtësisë është e përkushtuar për zbatimin e reformave që



synojnë modernizimin e sistemit korrektues duke shtuar se do të sigurojmë që çdo institucion korrektues të funksionojë sipas ligjit, me standarde të larta profesionale. “Forcimi i kontrollit dhe shtimi i përgjegjësisë do të jenë brenda fokusit tonë”, u shpreh Sallahu.



FSK-ja PO REALIZON USHTRIMIN FUSHOR “UJKU SHIGJETË”

Prishtinë, 3 shtator - Forca e Sigurisë së Kosovës është duke realizuar ushtrimin fushor “Ujku Shigjetë” në kuadër të parapërgatitjeve për validimin e Regjimentit të Tretë të Forcave Tokësore. Ky ushtrim

ka për qëllim testimin dhe ngritjen e kapaciteteve operacionale të pjesëtarëve të FSK-së të cilët po dëshmojnë disiplinë, profesionalizëm dhe përkushtim për përmbushjen e misionit dhe detyrave të

tyre. Me këtë ushtrim FSK-ja afirmon gatishmërinë dhe aftësinë për ta përmbushur misionin e një force profesionale në shërbim të vendit dhe qytetarëve.

Kryetari Latifi pret në takim Feride Rushitin

RAHOVEC, 3 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur të mërkurën në zyrë Feride Rushitin me bashkëpunëtorë nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e

të Mbijetuarve të Torturës. Ata biseduan për të mbijetuarat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, për viktimat, për heshtjen e gjatë dhe për stigmën që ende

mbartet mbi ta. Rushiti i dhuroi dy libra, përmbledhje rrëfimesh të grave, burrave dhe djemve që nuk u kursyen nga brutaliteti i luftës, si dhe të familjarëve të

tyre, si një thirrje e fuqishme për të mos harruar, për të treguar të vërtetën e dhimbshme dhe për ta vazhduar ballafaqimin me të kaluarën.



KURTI NUK SHKOI NË PROKURORI SI DËSHMITAR PËR REZERVAT SHTETËRORE, SHKOI NË GJYKATË SI VIKTIMË E KANOSJES

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Dy të akuzuarit për kanosje ndaj kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, janë deklaruar të pafajshëm gjatë seancës fillestare të mbajtur në Gjykatën Themelore në Prishtinë më 3 shtator.

I pranishëm në gjykatë ishte edhe Kurti, në cilësinë e të dëmtuarit, i cili tha se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike, raporton “Betimi për drejtësi”.

Faton Klinaku dhe Nuredin Selmani u deklaruan rreth fajësisë, pasi prokurori Bekim Kodraliu lexoi aktakuzën. “Konsideroj se nuk ka vepër penale dhe nuk bëhet fjalë për kurrfarë kanosje dhe nuk e pranoj”, tha Klinaku.

Ndërkaq, i akuzuari tjetër, Nuredin Selmani, po ashtu u deklarua i pafajshëm. “Jo, nuk i pranoj akuzat”, tha ai.

Pas kësaj, gjykatësi Rrahman Beqiri njoftoi mbrojtësit e të akuzuarve se brenda 30 ditësh mund të paraqesin kundërshtim

të provave.

Pas paraqitjes së Kurtit në gjykatë në cilësinë e palës së dëmtuar, politikanë nga partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë, thanë se Kurti nuk paraqitet tek organet e drejtësisë për rastet korruptive. Ata kujtuan se Kurti nuk ka shkuar në Prokurorinë Speciale për të dëshmuar për rastin që ka të bëjë me dyshimet për keqpërdorime në rezervën shtetërore.

Deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka shkruar në “Facebook” se kur bëhet fjalë për aferat milionëshe të vartësve të tij, Kurti refuzon t’i përgjigjet prokurorisë. “Pra, A.K. shkon në gjykatë për të dëshmuar kundër Klinakut, ‘krimi’ i të cilit ishte një status në ‘Facebook’. Por, kur bëhet fjalë për aferat milionëshe të vartësve të tij, refuzon t’i përgjigjet prokurorisë. Kush ka sy me pa dhe vesh me dëgju, e kupton se situata është më se e qartë”, ka shkruar Çitaku.

Edhe deputetja e LDK-së,



Hykmete Bajrami, ka theksuar se sot deputeti Kurti u shfaq në gjykatë si viktimë në një rast të kanosjes. “Veç paramendoni makinerinë e Kurtit dhe VV-së dhe sa kërcënime e kanosje u kanë bërë të tjerëve! Deputeti Kurti po tregon qartë se ligji është i drejtë vetëm kur i shërben interesave të tij personale. Ai, që mban jashtëligjshëm pozitën e kryeministrit në detyrë, e sheh drejtësinë si tavolinë suedeze: merr çka i duhet dhe refuzon çka nuk i pëlqen”, ka shkruar Bajrami në “Facebook”.

Por, zëdhënësi i qeverisë në detyrë, Përparim Kryeziu, tha se “paraqitja e kryeministrit Kurti në gjykatë për rastin e kanosjes ndaj tij nuk është kurrfarë standardi i dyfishtë në raport me ftesën nga Prokuroria Speciale”. “Sa i përket ftesës së Prokurorisë Speciale, kryeministri Kurti asnjëherë nuk ka refuzuar ta japë dëshminë e tij. Përkundrazi, ai ka shprehur gatishmërinë e plotë për të

bashkëpunuar me drejtësinë dhe për ta respektuar parimin e transparencës dhe llogaridhënies, duke kërkuar që intervistimi të zhvillohet në zyrën e tij, një praktikë kjo që ka ndodhur edhe më parë”, tha Kryeziu. Ai shtoi se për rastin e kanosjes, zyrtarët hetues, të autorizuar nga Prokuroria më 10 qershor të këtij viti, e kanë intervistuar Kurtin në zyrën e tij në ekzekutiv.

Për çfarë akuzohen Klinaku dhe Selmani?

Më 1 gusht Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi për ngritjen e aktakuzës ndaj Klinakut dhe të pandehurit tjetër, Selmani. Prokuroria tha se ata dyshohet se më 2023 kishin publikuar në llogaritë e tyre në “Facebook” shkrime me përmbajtje kërcënuese ndaj Kurtit. Pas publikimit të lajmit për aktakuzën, Klinaku, nga

Organizata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shkroi në “Facebook” se “mezi pret” të ballafaqohet me Kurtin në gjykatë.

Prokuroria Speciale e Kosovës tha se më 30 gusht të vitit 2023 Klinaku e kishte përsëritur një postim me përmbajtje kërcënuese ndaj Kurtit ku thuhej: “... Prapë po e përsëris, nëse ju duket skandaloz postimi i mëhershëm: Më parë e vras A. K. sesa t’ia lëshoj rrugën dhe të iki nga Kosova”.

Ndërkaq, Nuredin Selmani, sipas Prokurorisë Speciale, e ka kanosur me vrasje Kurtin përmes postimeve të bëra në “Facebook”, për shkak të funksionit të tij si kryeministër, duke iu referuar postimit kërcënues të Klinakut. Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që synon që përmes dhunës apo kanosjes t’i pengojë përfaqësuesit e lartë të Kosovës t’i kryejnë detyrat e tyre mund të dënohet nga 3 deri në 10 vjet burgim.

Mesazh kërcënues ndaj Kurtit në Mitrovicën e Veriut, policia nis hetimet

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Një mesazh kërcënues ndaj kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, është shfaqur në Mitrovicën e Veriut të martën në mbrëmje.

Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se bëhet fjalë për një mbishkrim të shkruar në një mur në rrugën “Vasilje Ostrovski”, në qytetin e banuar me shumicë

serbe. Sipas Elshanit, pas konsultimit me prokurorin kujdestar, është iniciuar rasti për kanosje.

Elshani ka thënë se deri më tani nuk ka persona të dyshuar dhe as të arrestuar lidhur me këtë incident. Ai ka shtuar se i njëjti mbishkrim, i shoqëruar me pamje grafike, ishte publikuar më herët në platformën e bisedave “Telegram”.

Në grupin “Koridor”, në këtë aplikacion, janë shpërndarë

fotografi me mbishkrimin: “Sa Kosova zora svice, Albin Kurti mrtav bice” (shqip: “Në Kosovë do të agojë mëngjesi dhe Albin Kurti do të jetë i vdekur”).

Një tjetër fotografi paraqet të njëjtin mbishkrim, por edhe një imazh, ku një person i maskuar mban në njërin dorë kokën e Kurtit dhe në tjetrën një sëpatë.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se po vazhdon hetimet lidhur me rastin.



Kurti viziton kompaninë “Fe Plast” në Prizren, e vlerëson shembull për bizneset

PRIZREN, 3 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, së bashku me deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, njëherësh kandidat për kryetar të komunës së Prizrenit, dhe Arbër Rexhaj, ka vizituar kompaninë “Fe Plast”. Kryeministri Kurti ka theksuar se “Fe Plast” në Prizren është kompani tash e 10 vjet që merret me prodhimin e

roletave për dritare, por ngritjen e zgjerimin më të madh e ka përjetuar në pesë vitet e fundit. “I ka 110 punëtorë në dy ndërrime. Asnjëri nuk ka pagë më të ulët se 650 euro. 80 % të prodhimit e eksportojnë në gjithsej 24 shtete: përveçse në rajon të Ballkanit Perëndimor e në vendet e BE-së, edhe në shtete të tjera, nga Ukraina në Evropën Lindore e deri te

Egjipti e Libia në Afrikën Veriore. Makinaria e automatizuar është moderne dhe prodhim italian. ‘Fe Plast’ është shembull i biznesit që punon, prodhon, eksporton dhe fiton”, ka thënë Kurti, duke shtuar se mbështetjes së nivelit qendror për bizneset, me Artanin kryetar do t’i bashkohen edhe kujdesi dhe përkrahja e nivelit lokal.



RRITJA HISTORIKE E ÇMIMIT TË ARIT, SI PO E DËMTON DOLLÄRIN AMERIKAN?

UASHINGTON, 3 SHTATOR - Një çmim historik për asetin më të vjetër të sigurt në botë tregon uljen e besimit në dollar dhe shtimin e presionit mbi Rezervën Federale Amerikane. Çmimi i arit u rrit në një nivel rekord prej 3 508.50 dollarësh (3 015.08 euro) për ons 2 shtator, i nxitur nga pritshmëritë për uljen e normës së interesit nga Rezerva Federale e ShBA-së dhe pasiguria në rritje për investitorët.

Ky metal i çmuar konsiderohet strehë e sigurt për investitorët, me kërkesën për të që rritet kur bie besimi në stabilitetin e valutave ose tregjeve financiare, raporton euronews.

Në fillim të këtij viti çmimet e arit u rritën kur presidenti amerikan Donald Trump njoftoi një sërë tarifash kundërthënëse ndaj vendeve të tjera, transmeton “Telegrafi”.

Vlera rekord e arit nënvizon shqetësimet e thella mbi perspektivën globale dhe pyetje mbi pavarësinë e Rezervës Federale, ndërsa Trumpi shton presionin mbi politikëbërësit. Rritja e çmimeve të arit ka qenë pjesë e një rritjeje shumëvjeçare për metalet e çmuara.

Dollari nuk është më ‘standardi i artë’

Rritja e çmimeve të arit ka ardhur si pjesë e një rritjeje shumëvjeçare të metaleve të çmuara. Bankat Qendrore nga Azia deri në Lindjen e Mesme kanë përshpejtuar blerjet e tyre për vitin e katërt me radhë, duke u dhënë një shtytje të fuqishme



çmimeve, me parashikime që të paktën 1 000 tonë metrikë ari do të blihen nga qeveritë për rezervat e tyre të arit.

Ky veprim tregon një ulje të varësisë nga dollari amerikan në një kohë kur trajektorja fiskale dhe betejat politike në Uashington po errësojnë pozicionin e tij si valuta rezervë botërore.

Një anketë me 73 banka qendrore, e kryer nga Këshilli Botëror i Artë, zbuloi se pritet që 95 për qind e tyre t’i rrisin rezervat e arit gjatë 12 muajve të ardhshëm, ndërsa thuajse tri të katërtat e tyre pritet t’i reduktojnë rezervat e dollarëve. Kina, e cila ende është në negociatë me ShBA-në për një marrëveshje tregtare më të

favorshme, ka qenë duke grumbulluar ari çdo muaj, duke regjistruar muajin e nëntë radhazi të blerjeve në korrik.

De-dollarizimi do ta dëmtojë monedhën më të besueshme në botë

Gjatë pjesës më të madhe të historisë moderne, shumica e valutave kombëtare ishin të lidhura drejtpërdrejt me arin - që do të thoshte se qeveritë garantonin se paratë prej letre mund të shkëmbeheshin për një peshë të caktuar ari që kishin ruajtur në rezervat e tyre. Transaksionet e përditshme bëheshin me para letre, pasi ishte shumë më e thjeshtë sesa

të llogariteshin vlerat e arit ose të përdorej monedha prej ari. Ndërkohë, qeveritë mbështesnin këto nota me arin që mbahej i sigurt në depozitat e tyre.

Pas Luftës së Dytë Botërore, dhjetëra vende Aleate u mbledhën në Bretton Woods, në New Hampshire, për të organizuar Konferencën Monetare dhe Financiare të Kombeve të Bashkuara. Ata vendosën të krijonin Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, dhe themeluan një sistem ku dollari amerikan ishte i lidhur me arin në vlerën 35 dollarë për një ons. Me fjalë të tjera, një dollar përfaqësonte 1/35 të një onsi. Në atë kohë, kjo lidhje i jepte

dollarit një besueshmëri të pakrahasueshme sepse ShBA mbante shumicën e rezervave të arit në botë.

Ky sistem siguroi stabilitet për tregtinë dhe investimet globale për rreth 27 vjet, deri në vitin 1971 kur ShBA hoqi lidhjen me arin, duke rrëzuar sistemin e Bretton Woods.

Fantazmat e Bretton Woods

Bretton Woods u rrëzua në vitin 1971 kur deficitit dhe inflacioni në ShBA zbrazën rezervat e arit, duke bërë që lidhja prej 35 dollarësh të bëhej e paqëndrueshme.

Presidenti amerikan Richard Nixon në atë kohë përfundoi konvertueshmërinë e dollarit, duke detyruar valutën të ketë luhatje.

Pasi valutave iu lejua të luhaten pas Bretton Woods, tregjet e këmbimit valutor, ose Forex, u bënë arena ku përcaktohen vlerat e tyre. Në vend që qeveritë të garantonin norma fikse, tani tregtarët, bankat blejnë dhe shesin valuta kundrejt njëra-tjetrës, me çmime që ndryshojnë ndonjëherë edhe sekondë pas sekonde.

Tani politikat e ShBA-së po ndikojnë sërish në zakonet e blerjes së arit të bankave qendrore, dhe është veçanërisht simbolike që ari ka kapërcyer vlerën prej 3,500 dollarësh për ons - një rritje prej më shumë se 10 mijë për qind nga lidhja prej 35 dollarësh e vendosur nën Bretton Woods pas Luftës së Dytë Botërore.

Zbulohet laborator droge në Prishtinë, vjedhje e energjisë elektrike mbi 32 mijë euro

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Në Prishtinë, gjatë kontrollit për keqpërdorim të dyshimtë të energjisë elektrike, ekipet e KEDS-it hasën në një gjë të pazakontë.

Në bodrumin e një lokali të vogël, kafe-bar, ekipet e kontrollit të KEDS-it kanë zbuluar një laborator drogash, ku një rrjet i tërë pajisjesh elektrike - drita me fuqi të lartë, ventilatorë, furra,

sisteme ftohjesh e pajisje të tjera - funksiononin përmes përdorimit të energjisë elektrike në të zezën.

Kjo vjedhje industriale e energjisë elektrike, e kalkuluar me një shifër prej mbi 217 mijë kW/h, përveçse abuzim me sistemin elektroenergetik, rrezikon edhe sigurinë e të gjithëve përreth. Sipas përlogaritjes, pronari i këtij “biznesi” detyrimisht ia rikthen

KEDS-it 32,670.99 euro në kuadër të procesit të rikthimit të humbjeve.

Ky konsumator dhe të gjithë ata që kapen duke e keqpërdorur energjinë elektrike, përballen pashmangshëm edhe me një proces gjyqësor në gjykatat kompetente të Republikës së Kosovës, ku mund t’i presë një dënim i majmë me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet.



KALIFATI TANI NDODHET NË AFRIKË



Masakra e fundit ndaj të krishterëve në Afrikë mban firmën e një milicie islamiste që vepron në provincën e Iturit, në pjesën më lindore të Republikës Demokratike të Kongos. Objektivi ishte kisha katolike, në territorin e Komandës, gjatë një takimi lutjeje dhe bilanci i fundit flet për të paktën 43 persona të vrarë me armë zjarri dhe me hanxharë, mes tyre gra, burra dhe edhe nëntë fëmijë. Rreth njëzet besimtarë u therën me thika gjatë meshës, ndërsa trupat e tjerë u gjetën në shtëpi dhe dyqane që u dogjën. Sulmi u mor përsipër nga milicia e quajtur Forcat Demokratike Aleate, më të njohura si ADF, një grup islamist ugandez që në vitin 2019 u betua për besnikëri ndaj Shtetit Islamik. Objektivi fillestar i këtij grupi ishte rrëzimi i regjimit të Kampalës, por që nga viti 2017 motivimi fetar ka marrë përparësi. Që nga viti 2020, ADF i janë bashkuar krijimit të Provincës së Afrikës Qendrore të Shtetit Islamik (ISCAP), një projekt i madh politiko-ushtarak që përfshin një territor që shtrihet nga Rajoni i Liqeneve të Mëdha deri në brigjet e

Mozambikut. Disfata e shpallur, por vetëm në dukje përfundimtare, e Shtetit Islamik në Lindjen e Mesme në vitin 2017 ndryshoi objektivat e këtij rrjeti të terrorizmit ndërkombëtar, i cili u fokusua mbi kontinentin afrikan. I ndarë në tre makro-zona që shtrihen nga Saharaja deri në Gjirin e Guinesë e deri në Afrikën jugore, objektivi i udhëheqësve të ISIS është krijimi i një kalifati në tokën afrikane. Provinca të tëra të Malit, Burkina Fasos, Nigerisë dhe Kongos tashmë administrohen nga fundamentalistët që imponojnë ligjin islamik dhe konvertimin e detyruar, por që sidomos synojnë shfarosjen e të krishterëve që jetojnë në ato rajone. Ndjekësit ugandezë të Shtetit Islamik nuk kishin goditur që nga shkurti i kaluar, kur kishin vrarë 23 persona në Mambasa, gjithmonë në provincën e martirizuar të Iturit. Në Kongon lindore komuniteti i krishterë ka qenë shënjestër e sulmeve prej vitesh dhe ADF kanë marrë përsipër që nga fillimi i vitit edhe dy sulme të tjera gjatë natës, ku kanë humbur jetën të paktën 70 persona. Sipas të

dhënave të Kombeve të Bashkuara këta milicë kanë vrarë mbi 7.000 civilë që nga viti 2014, duke u bërë një nga milicitë më gjakatare dhe më të organizuara të vendit, me financime private nga Katari dhe Arabia Saudite. Objektivi i këtij krahu të ISIS është të terrorizojë popullsinë dhe të marrë kontrollin e territorit, ku mungon plotësisht prania e shtetit qendror. ADF menaxhojnë disa miniera nga të cilat nxjerrin ilegalisht minerale. I kontrabandojnë në Ugandë, bashkë me dru dhe burime natyrore, duke shfrytëzuar vendasit si skllevër. Të krishterët, që përbëjnë mbi 90 për qind të popullsisë kongoleze, janë objektivi i tyre kryesor me rrëmbime dhe konvertime të detyruara, sidomos të grave të reja. Aimé Lokana Dhego është famullitari i fshatit të djegur dhe kur flet, zëri i dridhet ende: “Kisha është një grumbull rrënojash, po këndonim kur ata erdhën. Tani të rinjtë tanë janë vrarë dhe rrëmbyer, ne kërkojmë paqen dhe nuk arrijmë ta kuptojmë gjithë këtë urrejtje. Por duam të rindërtojmë famullinë dhe të rifillojmë nga besimi që mund të na

shpëtojë.” Dieudonné Duranthabo, përfaqësues i shoqërisë civile të territorit të Komandës, është ndër ata që kanë hapur varret për trupat: “Masakra filloi rreth mesnatës, u ndanë në grupe të vogla dhe sulmuan njëkohësisht kishën dhe shtëpitë përreth, një strategji që përdorin për të çorientuar popullsinë që nuk di nga të ikë. Ende po nxjerrim trupat, shumë prej të cilëve të copëtuar me hanxhar, sepse disa u ndoqën në pyll, ndërsa të tjerë u rrëmbyen dhe u vranë gjatë arratisjes. Ata nisën që ditën e mëparshme duke vrarë 5 persona në fshatin fqinj Machongani. Nuk dimë as sa persona janë rrëmbyer, sepse shumë tashmë kanë braktisur fshatin nga frika se mos terroristët kthehen. E konsideroj absurde që në këtë territor ka një numër të madh forcash sigurie dhe askush nuk arriti të ndërhyjë; duhet një përpjekje e menjëhershme ushtarake, sepse ata të ADF janë ende pranë fshatit tonë.” Forcat e sigurisë kongoleze ndërhynë vetëm pasi vunë re tym që dilte nga banesat rreth orës 2 të mëngjesit, por nuk arritën të kapnin agresorët.

Në qytet të gjitha aktivitetet janë pezulluar dhe shumë banorë, të pushtuar nga paniku, kanë ikur tashmë. Toger Jules Ngongo, zëdhënësi i ushtrisë kongoleze në provincën e Iturit, ripërsërit angazhimin e forcave të armatosura: “Këta terroristë vazhdojnë të sulmojnë civilë të pambrojtur, ky akt i turpshëm kundër famullisë së Komandës është një përpjekje e dëshpëruar për të shpërqendruar vëmendjen nga operacioni ushtarak i përbashkët me ushtrinë ugandeze që ka në shënjestër grupin militant. Por ne do të vazhdojmë t'i ndjekim këta kriminelë deri në fortesën e tyre të fundit. I bëjmë thirrje popullsisë të mos ikë dhe të qëndrojnë vigjilente, duke na njoftuar për çdo lëvizje të dyshimtë.” Që nga fundi i vitit 2021 Kampala dhe Kinshasa kanë nisur operacionin ushtarak Shujaa (që në suahili do të thotë Trim), por deri më sot rezultatet janë të papërfillshme dhe përkundrazi i kanë lejuar Ugandës të marrë kontrollin e një pjese tjetër të këtij gjigandi në agoni të quajtur Kongo.



Superkupa zhvillohet në Ferizaj

Gara për Superkupën e Kosovës në hendboll do të zhvillohet në palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj. Turneu i Superkupës

zhvillohet më 13 shtator. Organizimin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme e bën KH Kastrioti. Kontrata për organizimin e

Superkupës është nënshkruar nga presidenti i FHK-së, Edin Kolgeci dhe kryetari i KH Kastrioti, Fisnik Jashari. Nga ora

17:30 luhet ndeshja e hendbollisteve në mes të Istogut dhe Ferizajt. Ndërkohë hendbollistët e Rahovecit dhe

Kastriotit takohen nga ora 20:00. Priten ndeshje interesante, numër i madh shikuesish dhe atmosferë e bukur sportive.

VOJVODA DHE JASHARI: SYNOJTMË FITORE NDAJ ZVICRËS

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të mërkurën e ka zhvilluar stërvitjen e fundit në Kampin Nacional në Hajvali para se ta nisë udhëtimin për në Bazel. “Dardanët” të premten e zhvillojnë ndeshjen e parë të ciklit kualifikues për Kupën e Botës 2026 kundër Zvicrës. Në seancën stërvitore përzgjedhësi Franco Foda ka fokusuar punën në detaje taktike, duke theksuar organizimin ofensiv dhe mbrojtës, si dhe ndërprerjen dhe reagimin e ekipit gjatë fazave të tranzicionit në lojë, kurse atmosfera në kampin e “dardanëve” është shumë pozitive, ndërsa futbollistët po punojnë me përkushtim të lartë. Mbrojtësi Mërgim Vojvoda ka përmendur rëndësinë e mbështetjes së bashkatdhetarëve në ndeshjen e parë në Bazel. “Atmosfera është shumë e mirë. E dimë që na presin dy ndeshje të vështira. E dimë sa e vështirë është të luash në Zvicër, po ashtu e dimë që do të kemi shumë përkrahje nga tifozët. Djemtë janë të gjithë të përgatitur dhe stërvitet po shkojnë shumë mirë. Jemi duke u bërë gati për të shkruar atje dhe për të marrë tri pikë. Qëllimi ynë është të marrim gjashtë pikë, por natyrisht që do të jetë e vështirë pasi të dy ekipet janë favorite, por ndonjëherë kjo është më mirë, sepse presioni nuk është te ne, por tek ata. Po punojmë që të fitojmë tri pikë si në Zvicër ashtu edhe në ndeshjen në shtëpi kundër Suedisë dhe shpresoj që kështu



do të ndodhë”, ka thënë Vojvoda. Sikurse mbrojtësi i krahut të djathtë, Mërgim Vojvoda edhe mesfushori Muharrem Jashari janë optimistë për performancën e ekipit dhe beson në një rezultat pozitiv. “Jemi përgatitur maksimalisht për ndeshjen me Zvicrën. Atmosfera është shumë e mirë dhe presim një rezultat pozitiv, pasi kemi analizuar kundërshtarin dhe njohim pikat e tij të forta dhe të dobëta.

Sigurisht, në Zvicër na pret një mbështetje e madhe dhe shpresojmë të japim më të mirën, të arrijmë një rezultat pozitiv dhe të kënaqim tifozët me paraqitjen tonë”, ka deklaruar Jashari. Ekspedita e “Dardanëve” do të udhëtojë sot (e enjte) në mëngjes drejt Bazelit, ku do të zhvillojë edhe një seancë stërvitore para ndeshjes me Zvicrën, që do të luhet më 5 shtator në stadiumin “St. Jakob-Park”.

Shkurt

Joe Reece, amerikan i tretë që përforcon KB Ylli

Basketbollisti amerikan Joe Reece është përforcimi më i ri te Golden Eagle Ylli për sezonin 2025/26 në Superligën e Kosovës në basketboll. Skuadra nga Suhareka të mërkurën e ka zyrtarizuar basketbollistin e gjatë 203 centimetra, i cili luan në pozitën 3. Reece në Evropë, karrierë ka bërë edhe në Maqedoni të Veriut dhe Austri, ku sezonin e fundit te skuadra Gmunden ka luajtur me një mesatare prej 15 pikëve, 7 kërcimeve e 2 asistimeve. Reece është përforcimi i katërt i huaj dhe amerikan i tretë, pasi Ylli më herët ka zyrtarizuar edhe Trevon Allen, Dwayne Cohill e Lovre Bashiq. Sa iu përket vendorëve, pjesë e Yllit në sezonin e ri do të jenë Erjon Kastrati, Lis Shoshi, Artin Gashi, Arian Qallaku e Gëzim Morina. Ndërkohë, në krye të ekipit është trajneri nga Greqia, Fotis Takianos, me të cilin tashmë ka nisur përgatitjet për sezonin e ri.

Akanji: Kosova është e fortë, por synojmë fitore

Ylli i ekipit kombëtar të Zvicrës, Manuel Akanji, ka folur në konferencë për shtyp para sfidës së të premtes me Përfaqësuesen e Kosovës. Futbollisti më i ri i Interit e ka vlerësuar lart ekipin “dardan”, por ka insistuar se “helvetikët” duhet ta fitojnë këtë lojë për ta nisur mirë kampanjën kualifikuese të Botërorit 2026. “Ne nuk e patëm një kampanjë të mirë në kualifikimet e Kampionatit Evropian. Barazuam dy herë pasi na shënuan në minutën e fundit. Këtë të premte, patjetër do të synojmë ta fitojmë ndeshjen dhe besojmë se mundemi. Por, nuk është një kundërshtar i lehtë (Kosova), ata janë shumë të fortë dhe agresivë. Ne duhet të jemi gati. E dimë që gjithçka fillon të premten”, u shpreh futbollisti i deridjeshëm i Manchester Cityt. Zvicra dhe Kosova do të përballen mes vete këtë të premte në Basel në ndeshjen që do të fillojë prej orës 20:45.

Caktohet data e Superkupës dhe fillimit të edicionit të ri në volejboll

Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK) në mbledhjen e radhës të bordit ka marrë vendime të rëndësishme që lidhen me zhvillimet e brendshme dhe përgatitjet për sezonin e ri garues 2025/26. Fillimisht, Bordi i FVK-së aprovoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar, si dhe raportin e kombëtareve seniore për kualifikimet e CEV EuroVolley 2026, duke vlerësuar përkushtimin dhe paraqitjet e ekipit kombëtar në këtë cikël garash. Një pjesë e veçantë e mbledhjes iu kushtua përgatitjeve për sezonin e ri 2025/26, ku u përcaktua edhe kalendari i garave kombëtare: Superkupa në konkurrencën e femrave do të zhvillohet më 20/21 shtator 2025, kurse Superliga A në të dy konkurrencat do të nisë më 27/28 shtator 2025. Superliga B dhe Liga e Parë do të startojnë më 4/5 tetor 2025.

Ujkani: Barça dhe Real i shih interesuar për Zhegrovën, por ia propozova Juventusin

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Barcelona dhe Real Madridi kishin shprehur interesim për Edon Zhegrovën. Për këtë flet zëvendësudrejtori i Kombëtares së Kosovës, Samir Ujkani. Ish-portieri i njohur nga Kosova, i cili pjesën më të madhe të karrierës e kaloi në futbollin

italian, ka zbuluar prapaskena nga muajt e kaluar kur ylli nga Kosova ishte në kërkim të ndërrimit të ekipit, para se të vendoste përfundimisht për Juventusin ditë më parë. “Së fundmi nuk e di, por muaj më parë Zhegrova pëlqej shumë në Spanjë: Barcelona dhe Real

Madridi kishin kërkuar informacione për të dhe i kishin bërë hapat e parë. Në përgjithësi ishte mjaft i vlerësuar”, u shpreh Ujkani për mediumin italian “Tuttosport”. “Në Itali, ndërkohë, Napoli besoj se ka qenë i pari i interesuar. E, në fakt, Edoni më

kërkonte paksa më shumë informacione për kampionatin italian. Por, në fund nuk u bë asgjë. E tash jam i lumtur ta shoh në Juventus, ku ia këshillova lojtarin trajnerit Tudor”, përfundoi ish-përfaqësuesi i Shqipërisë dhe i Kosovës.



Serebe, ‘Ylli i javës’ në Superligë

SUHAREKË, 3 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e tretë i është dhënë futbollistit të FC Ballkanit, Valentin Serebe, i cili shënoi dy gola në ndeshjen kundër FC Ferizajt në udhëtim (1:3), duke

shënuar golat e epërsisë për tri pikët e suharekasve. “Jemi përgatitur që nga java e kaluar për këtë ndeshje bashkë me trajnerët dhe bashkëlojtarët e mi. U përgatitëm për këtë ndeshje sepse kishim nevojë për fitoren. Fillimisht, gjëja më e rëndësishme ishte të fitonim dhe pastaj, me ndihmën e

Zotit, arritëm fitoren. Shënova dy gola dhe jam shumë i lumtur dhe i kënaqur me këtë ndeshje”. Gjithçka po shkon mirë. Të gjithë më kanë pritur mirë mua. Populli, të gjithë e duan shumë qytetin. Suhareka është vend i qetë. Qëllimi i klubit është ta mbyllim sezonin si kampionë, ta

fitojmë kampionatin. Kupa është gjëja më e rëndësishme për klubin. Sa më përket mua, ambicia ime është të jem golashënuesi më i mirë. Do të përgatitemi për këtë sezon dhe, me ndihmën e Zotit, gjithçka do të shkojë si duhet”, ka deklaruar ai për faqen zyrtare të FFK-së.



Demolli: Donjeta Sadiku synon të shpallet kampione në Botërorin e Boksit

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Nga 4 deri më 14 shtator në Liverpool të Anglisë do të zhvillohet Kampionati Botëror i Boksit, ku do të marrë pjesë edhe Kosova. Në këtë turne, Kosova do të paraqitet me katër garues, të kryesuar nga boksierja Donjeta Sadiku, si dhe Bashkim Bajoku, Shpëtim Bajoku dhe Loris Idrizi. Sekretari i Federatës së Boksit të Kosovës, Latif Demolli, ka thënë për “KosovaPress” se kjo federatë i ka dhënë shumë rëndësi këtij kampionati dhe se ekipi është përgatitur maksimalisht për të kërkuar rezultate të mira në këtë garë. “Ne i kemi dhënë rëndësi këtij Kampionati Botëror për arsye se është ndër evenimentet më të mëdha për vitin 2025. Para dy javësh e kemi dërguar Donjeta Sadikun në Sheffield të Anglisë në kampin ndërkombëtar, ku kanë qenë tetë shtete, kurse djemtë (Shpëtim Bajoku, Bashkim Bajoku dhe Loris Idrizi) kanë qenë në Sofje të Bullgarisë ku, po ashtu, kanë qenë në kamp ndërkombëtar dhe kanë zhvilluar përgatitje të mira për arsye se kanë



pasur sparingje, të cilat në Kosovë nuk i kemi me boksierë të nivelit të lartë”, ka deklaruar Demolli. Sa i përket Donjeta Sadikut, Demolli thekson se ajo është e bindur në sukses dhe se pret ta shpallë kampione bote. “Donjeta ka qenë në formë të mirë, ka pasur një ftohje për tri apo katër ditë, por ajo është kaluar dhe është në formën e duhur. Presim që medaljen e bronzitë që ka nga Kampionati Botëror në Turqi ta shndërrojë në Liverpool në medalje të artë dhe besoj e

shpresoj që Donjeta do të jetë kampione e botës, kurse nga djemtë presim që të marrim minimumi një medalje, pa marrë parasysh nëse është e artë, e argjenditë apo e bronzitë”, ka shtuar tutje Demolli. Ai bëri me dije se edhe në këtë kampionat ekspedita e Kosovës ka udhëtuar me disa telashe financiare, pasi është dashur që ato të sigurohen përmes huazimeve dhe pastaj të kthehen kur Ministria e Sportit t’i lëshojë pagesat e rregullta. “Ne, si gjithnjë deri më sot, ia dalim të huazojmë mjete për t’i paguar shpenzimet, dhe pasi të dalin mjetet nga ministria i kthejmë ato, sikur gjithnjë deri më tani, për arsye se në këtë federatën e re World Boxing duhet që tre muaj përpara ta paguajmë hotelin, biletat – që është një mangësi – por besoj që në të ardhmen kjo do të përmirësohet, sepse tre muaj përpara nuk mund ta paraqesim ekipin kur mundet ndonjë boksier të pësojë ndonjë lëndim dhe të mos marrë pjesë”, ka deklaruar Demolli.

Hamiltoni, tri gara për ta shmangur ‘rekordin e zi’

MONZA, 3 SHTATOR - Rrugëtimi i vështirë i Lewis Hamiltonit me Ferrarin duket se nuk po njih fund. Pavarësisht se mbërriti në Holandë me shpresën për një “fillim të ri” pas pushimit veror, fati ishte sërish i pamëshirshëm me të. Në xhiron e 22-të, gjatë daljes nga kthesa e tretë, ai humbi kontrollin e makinës SF-25 dhe përfundoi në barriera, duke mbyllur para kohe garën. Ishte “zeroja” e dytë radhazi për të këtë sezon për shtatë herë kampionin e botës. Me 15 Çmime të Mëdha të zhvilluara, britaniku vazhdon ta zgjasë serinë më të keqe të karrierës së tij, duke mos u ngjitur në podium asnjëherë deri më tani (fitorja në Sprintin e Kinës nuk llogaritet në statistikat zyrtare).



Kështu piloti britanik ndodhet tashmë në vendin e dytë të një klasifikimi të padëshiruar. Rezultati i fundit mjaftoi që ai të kalojë Ivan Kapelin në mesin e pilotëve të Ferrarit që kanë pritur më gjatë për të siguruar podiumin e parë me kostumin e kuq. Vendin e parë në këtë listë e mban Didier Pironi. Francezi zhvilloi 19

fundjava gare përpara se ta arrinte podiumin e parë me skuadrën nga Maranelo. Ai nuk pati sukses gjatë gjithë sezonit 1981, derisa arriti ta “shijonte” medaljen e parë në Çmimin e Madh të San Marinos në vitin 1982. Tani Lewisi ka edhe tri gara në dispozicion për ta thyer serinë negative dhe për të mos u regjistruar në këtë “rekord të zi”. Fundjava në Monza do të hapet këtë të premte me dy sesionet e para të provave të lira, të cilat do të mbahen përkatësisht në orën 13:00 dhe 17:00. Më pas të shtunën në orën 12:30 do të zhvillohet sesi i tretë i lirë, ndërsa në orën 16:00 do të fillojnë kualifikueset. Çmimi i Madh i Monzës do të nisë të dielën në orën 15:00.

SHKURT

Shearer kritikon Isakun: Pamje e keqe për futbollin

Legjenda e Newcastle's dhe e futbollit anglez Alan Shearer ka qenë shumë kritik ndaj transferimit të Alexander Isakut nga Magpies te Liverpooli. Marrëveshja vlerësohet në një rekord të Premierë Ligës prej 125 milionë funtash dhe u realizua pasi suedezi u zemërua dhe bojkotoi Newcastlein, duke refuzuar të luante për ekipin dhe të stërvitej me të. “Nuk më pëlqen se si përfundoi e gjitha. Nuk mendoj se është etike të protestosh në një mënyrë të tillë dhe të refuzosh të luash për një klub që të pagua një pagë dhe me të cilin ke një kontratë. I kuptoj rastet kur një klub dëshiron të shesë një lojtar sepse ta paguan shpërblimin. Kur nënshkruan një dokument, je i detyruar ta përmbushësh atë. Pamje e keqe për futbollin”, ka thënë Shearer.

Antony: Refuzova Bayernin për t’i dal në fjalë Betisit

Bayern Muncheni e kontaktoi Antonyn përpara se të transferohej nga Manchester Unitedi te Real Betis. Klubi bavarez thuhet se i ofroi sulmuesi anësor brazilian dyfishin e pagës së tij aktuale. Megjithatë, Antony vendosi ta respektojë angazhimin e tij dhe të transferohet te Betisi. 25-vjeçari e konfirmoi këtë për El Partidazo de COPE. “Fola me Bayern Munchen një ditë para se të nënshkruaja me Betisin. Nuk e di nëse oferta ishte 7 milionë euro [neto], nuk e diskutova këtë”, ka thënë Antony. “Por kur fola me ta, thashë se ia kisha dhënë fjalën Betisit dhe se gjithçka ishte bërë 95 % dhe do ta mbaj fjalën time. Nga respekti, dashuria dhe duke e ditur se jam i lumtur këtu. E marr këtë vendim me gjithë respektin për Bayern Munchenin, një nga tri klubet më të mira në botë. Nuk e di se çfarë do të ndodhë në të ardhmen”, ka shtuar Antony.

Ten Hagen u shkarkua pas 62 ditësh punë, fiton miliona euro

U shkarkua nga Manchester Unitedi për rezultate të dobëta, por duket se trajnerin Eric Ten Hag, e përcolli i njëjti fat edhe tek Bayer Leverkuseni. Në muajin maj ai arriti te “farmacistët” ku nënshkroi një kontratë trevjeçare dhe u duk se gjërat do të marrin një kahe të duhur. Por, vetëm pas dy ndeshjesh në Bundesligë, ku në ndeshjen e parë humbën kundër Hoffenheimit dhe në të dytën barazuan kundër Werder Bremenit, bëri që holandezi të shkarkohet. Sipas gazetës gjermane “Sport Bild”, shkarkimi i holandezit do t’i kushtojë klubit pothuajse 6 milionë euro në formë kompensimi për ndërprerjen e kontratës. Kur kësaj i shtohet edhe paga e tij për dy muajt e kaluar në stol, shifra që Ten Hag i kushtoi klubit del të jetë rreth 100 000 euro në ditë gjatë qëndrimit të tij 62-ditor në krye të ekipit gjerman. Ten Hagu është sërish në kërkim të një pune të re, dhe pas dy shkarkimeve në më pak se një vit, reputacioni i tij është dëmtuar ndjeshëm dhe mbetet për t’u parë se ku do ta vazhdojë karrierën e tij.

Galatasaray zyrtarizon transferimin e Gundoganit

Klubi turk Galatasaray ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e mesfushorit Ilkay Gundogan nga Manchester City. Kampioni turk nuk ka qëndruar duarkryq këtë verë, pasi ka bërë

disa transferime të mëdha për të konfirmuar përsëri titullin dhe për të qenë konkurrues në Ligën e Kampioneve. Transferimi i tyre i fundit i madh është reprezentuesi gjerman,

Gundogan, i cili ka qenë shumë i suksesshëm në të kaluarën me Borussia Dortmundin, Manchester Cityn dhe Barcelonën. “Është arritur një marrëveshje me Manchester

City Football Club për transferimin falas të futbollistit profesionist Ilkay Gundogan”. Është nënshkruar një kontratë me lojtarin, e vlefshme deri në fund të sezonit 2026/2027, sipas

kushteve të mëposhtme: “Një tarifë e garantuar sezonale prej 4 500 000 eurosh neto do të paguhet për sezonin 2025-2026, dhe 4 500 000 € neto për sezonin 2026-2027”, thuhet në njoftim.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Tricontes Prishtina” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810148735 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Tricontes Prishtina” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810148735 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Tricontes Prishtina” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810148735 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT



SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

Abirapa Teatr-i t, 4 Qullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gadaf Fetahu shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Halis Ademi shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Qendresa Kastrati shpall te pavlefshme dëftesën e kl V- IX shfmu “Brigada 125” Medvec
- Burim Buza shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

